

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shtator



01

CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATAVE PËR FITUESIT E THIRRJES SË KATËRT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË

Në ceremoninë e Nënshkrimit të Kontratave për fituesit e Thirrjes së Katërt për Projekt-Propozime, e cila u mbajt në datën 17 Shtator, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Muzhaqi u theksoi rëndësinë e vazhdueshme e mbështetjes së qeverisë për rininë, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Rininë. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, Z. Geron Ibrahim, hapi aktivitetin duke përmbledhur sukseset e vitit të kaluar dhe ndikimin që projektet e financuara nga Thirrjet e mëparshme kanë pasur në komunitetet përkatëse.

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi, ndau me pjesëmarrësit arritjet e qeverisë në mbështetje të të rinjve dhe organizatave rinore. Ajo theksoi rritjen e buxhetit për rininë si dhe angazhimin e 27,634 të rinjve në projektet e mbështetura nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për këtë thirrje. Përfaqësues të organizatave fituese nga Thirrja e Tretë ndanë përvojat e tyre, duke përmendur si projektet e tyre kanë ndihmuar rininë dhe kanë sjellë ndryshime pozitive.

Ministrja Muzhaqi nënvizoi rëndësinë e angazhimit dhe pasionit në realizimin e këtyre projekteve, duke i inkurajuar organizatat që të japin maksimumin për të ndikuar pozitivisht jetët e të rinjve. Ajo gjithashtu përmendi rëndësinë e programeve të financuara nga BE, si EU4Youth, duke theksuar rolin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë në menaxhimin dhe monitorimin e fondeve evropiane.



02

FILLIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Ministrja Bora Muzhaqi uroi Emën, Palomën dhe Elsën për nisjen e praktikës së tyre pranë Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, duke përfaqësuar 463 praktikantët të cilët po marrin pjesë në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës. Ky program, i cili është pjesë e përpjekjeve të qeverisë për të fuqizuar të rinjtë, synon të integrojë të rinjtë në administratën publike, duke u dhënë mundësinë të marrin përvojë praktike dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale.

Programi Kombëtar i Praktikave ka përfshirë praktikantët në fusha të ndryshme, duke i lidhur ata me institucione kyçe dhe duke krijuar ura të forta midis arsimit dhe tregut të punës. Praktikantët, të cilët punojnë në departamente të ndryshme, kanë mundësinë të mësojnë nga profesionistët dhe të kontribuojnë me ide të reja në administratë.

Ministrja Muzhaqi përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit dhe i inkurajoi që të përfitojnë maksimalisht nga kjo mundësi për të ndërtuar një karrierë të suksesshme. Ajo theksoi rëndësinë e përvojave të tilla për përgatitjen e të rinjve që do të marrin pjesë aktive në vendimmarrje dhe zhvillimin e administratës publike në të ardhmen.




REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRJA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shtator



03

THIRJE PËR APLIKIME: PROGRAMI "GJENERATA E INOVACIONIT"

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit si dhe Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencë, Ministri i Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët prezantoi programin "Gjenerata e Inovacionit", ku të rinjtë kanë një mundësi unike për të zhvilluar dhe ndarë idetë e tyre. Rruga fillon me aplikimin online, ku pjesëmarrësit mund të shprehin kreativitetin e tyre dhe të dërgojnë idetë që synojnë të sjellin ndryshim. Pasi idetë të dorëzohen, një komision ekspertësh do të vlerësojë ato më të spikaturat, duke përzgjedhur ato që kanë potencialin më të madh.

Të përzgjedhurit do të kenë mbështetjen e mentorëve profesionistë, të cilët do t'i udhëheqin në zhvillimin e mëtejshëm të ideve të tyre. Ky udhëtim inovativ do të kulmojë me një event prezantues, ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të ndriçojnë skenën dhe të prezantojnë idetë e tyre para drejtuesve të administratës publike.



04

KAMPI VEROR PËR FËMIJËT NË THUMANË

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, në bashkëpunim me organizatën Save the Children në Shqipëri, Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkinë Krujë kanë organizuar "Kampi Veror për Fëmijë" në njësinë administrative Thumanë. Kjo iniciativë vjen me qëllim përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe projekt pilot për një program kombëtar të aktiviteteve jashtëshkollore me fokus angazhimin e fëmijëve, zbulimin dhe zhvillimin e talenteve. Projekti është në vijim të programit arte dhe zeje që zhvillohet pas shkolle në 200 shkolla tashmë.

Gjatë vizitës së saj, Muzhaqi theksoi rëndësinë e ofrimit të mundësive të barabarta për fëmijët. Po ashtu përmes organizimit të kampit veror në Thumanë u synua realizimi i nivelit të dytë të "Programit Kombëtar për Aktivitetet Jashtë Orarit Mësimor (JOM)", i cili mundëson kurse të specializuara për nxënësit e ciklit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, që do të mundësohen nga ekspertë të fushës në qendra të dedikuara, dhe nga i cili 80 fëmijë nga Njësia Administrative Thumanë përfatuan nga lëndë të ndryshme si arte, anglisht, voleyboll, basketboll, muzikë, pikturë etj të ofruar falas për ta gjatë kampit veror në qendrën Atrium.



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shtator



05

VIZITA E MINISTRES MUZHAQI NË PRRENJAS PËR NISJEN E VITIT TË RI SHKOLLOR

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bora Muzhaqi, së bashku me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, Arbjan Mazniku, vizituan shkollat "Dalip Toçka" dhe "Qybra Sokoli" në Prrenjas me rastin e nisjes së vitit të ri shkollor. Të shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë Prrenjas, Nuri Belba, ata uruan nxënësit dhe mësuesit për një vit të suksesshëm.

Ministrja Muzhaqi theksoi rëndësinë e programeve të kodimit në shkolla, që ndihmojnë në zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive logjike të nxënësve. Shkolla "Qybra Sokoli" është një nga 100 shkollat e pajisura me smartlabs në kuadër të programit të kodimit në shkolla, në iniciativë e cila është zgjeruar edhe në 200 shkolla të tjera me 216 laboratorë të rinj këtë vit.



06




PËRPARIMI I PROGRAMIT TË KODIMIT NË SHKOLLA: 3 VITE SUKSESI

Ministrja Bora Muzhaqi, së bashku me ekipet e Code Monkey dhe AADF, zhvilluan një diskutim mbi rezultatet e programit të kodimit në shkolla, i cili po shënon sukses të jashtëzakonshëm në vitin e tij të tretë. Ky program ka integruar kodimin që nga klasa e parë, dhe tashmë është shtrirë deri në klasën e tretë, duke përfshirë një total prej 349 shkollash (306 publike dhe 43 private) në të gjithë vendin.

Me mbi 35,000 fëmijë dhe 363 mësues të angazhuar, ky program ka krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e aftësive teknologjike dhe mendimit kritik të brezave të rinj, duke u dhënë mundësinë të njihin dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e teknologjisë që në vitet e hershme të shkollimit. Diskutimi përqendrohej në arritjet e deritanishme dhe mënyrat për të zgjeruar më tej këtë nismë, që ka potencial të madh për arsimin dixhital në Shqipëri.



REPUBLIKA E SHqipëRIE
KRUEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT



DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Shtator



07

VIZITA NË HOLBERTON SCHOOL ALBANIA: MBËSHTETJA PËR AFTËSITË DIGJITALE TË TË RINJVE

Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me Ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhe, dhe Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, z. Klevis Hysa, vizituan Holberton School Albania, ku u zhvillua një takim me studentë dhe alumni që kanë ndjekur kurset e kodimit me mbështetje financiare nga Qeveria Shqiptare.

Ky program, i nisur në nëntor të vitit 2022, është një hap i rëndësishëm në përgatitjen e të rinjve me aftësi digjitale të vlefshme për tregun e punës. Deri tani, 1812 të rinj kanë përfituar nga këto kurse, prej të cilëve 189 kanë qenë punëkërkuar të papunë dhe kanë ndjekur kursin falas. Rreth 70% e pjesëmarrësve kanë arritur të punësohen pas përfundimit të trajnimeve.

Gjatë vizitës, ministrat dhe përfaqësuesit e Holberton diskutuan me studentët për përvojat e tyre, duke theksuar rëndësinë e programit në zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e një karriere të qëndrueshme. Programi i Kodimit synon të përfshijë edhe më shumë të rinj, duke krijuar mundësi të reja në sektorin e teknologjisë dhe duke kontribuar në zhvillimin e burimeve njerëzore të përgatitura për sfidat e së ardhmes.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRUEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT